

VENDIM
Nr.556, datë 11.8.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1061, DATË 8.7.2010
“PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE
TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË BURGJEVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ligjit nr.10 032, datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.1061, datë 8.7.2010 të Këshillit të Ministrave, lidhja nr.1, që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2011, të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2011 për rritjen e pagave.

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha